



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

Në bazë të dispozitave të nenit 12, paragrafi 12.2, shkronja **d** dhe nenit 14, paragrafi 1 të Ligjit nr. 03/L - 040, për vetëqeverisje lokale (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 28/15, qershor 2008), nenit 8, pika 3, nenit 11 nënparagrafi 3.1 të Ligjit nr. 05/L-092, për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës (“Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës”, nr. 10/03, prill 2019), nenit 23, paragrafi 6 të Rregullores QRK, nr. 09/2020, për përcaktimin e procedurave për dhënien në shfrytëzim dhe këmbimin e pronës së paluajtshme të Komunës, nenit 33.2, shkronja **a** dhe nenit 34.1 shkronja **d** të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391, të dt. 25.02.2010, Kuvendi i Komunës së Prishtinës, në mbledhjen e mbajtur më 10.05.2022, merr këtë:

V E N D I M
PËR DHËNIEN NË SHFRYTËZIM TË PRONËS SË PALUAJTSHME TË KOMUNËS
“THE SUNNY HILL”, SHPK

- I. **MIRATOHET** propozimi i Kryetarit të Komunës për dhënien e pronës së paluajtshme të Komunës në shfrytëzim afatgjatë “The Sunny Hill”, SHPK, Prishtinë.
- II. Prona e paluajtshme që do të jepet në shfrytëzim, ka këto karakteristika: Parcela kadastrale e identifikuar me certifikatë të pronësisë nr. P-71914024-00670-4, me sipërfaqe 140162 m² dhe parcela kadastrale me nr. P-71914024-00670-6, me sipërfaqe 29254 m², zona kadastrale Bërnice e Poshtme.
- III. Qëllimi i dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekur në pikën II të këtij vendimi, është zhvillimi i mëtutjeshëm i festivalit “Sunny Hill”, sigurimit të mbarëvajtjes së festivalit dhe kushteve optimale për rritjen e festivalit.
- IV. Afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme komunale, të përshkruar në pikën II të këtij vendimi, është afatgjatë, në periudhën për 99 vjet, duke e ruajtur të drejtën e ndërprerjes së kontratës në raste specifike..
- V. Prona e paluajtshme komunale e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, jepet në shfrytëzim afatgjatë 99 vjet, realizohet me procedurë të negociuar.
- VI. Mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme do të përcaktohen me kontratë, e cila lidhet dhe nënshkruhet në mes të Kryetarit të Komunës dhe përfaqësuesit të shfrytëzuesit.
- VII. Prona e paluajtshme komunale që jepet në shfrytëzim, e përshkruar në pikën II të këtij vendimi, duhet të evidentohet në librat kadastrale të Komunës.

VIII. Për zbatimin e këtij vendimi kujdesen: Kryetari i Komunës dhe drejtoritë kompetente të Komunës së Prishtinës.

IX. Pjesë përbërëse e këtij propozimvendimi janë:

- Kërkesa,
- Certifikatat e njësish kadastrale,
- Kopjet e planit për parcelat kadastrale nr. 670-4 dhe 670-6, zona kadastrale Bërnice e Poshtme,
- Marrëveshtja e negociuar me Kryetarit të Komunës dhe The Sunny Hill sh.p.k. me nr. 14.024/01-98798/22, të dt. 06.05.2022.

X. Ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në gjuhë zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

KUVENDI I KOMUNËS SË PRISHTINËS
01-463/01-104027/22, më 12.05.2022

KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina

